

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, më Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. Zh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë neni 333 prg.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore- Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1108/2017 të dt. 30.01.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me 09.03.2018, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.nr.1108/2017 e dt.30.01.2018,dhe kjo Gjykatë, jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

D. ZH., i biri i D. dhe i nënës B. e gjinisë B., data e lindjes....., në Gjakovë, nxënës, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me ID.....

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-Më dt.23.07.2017, rreth orës 04:05 min, në Gjakovë, Rr “.... “ të dëmtuarit Spitali Rajonal “....” – Reparti i Emergjencës, i dëmton xhamin e derës se gardërobës, ne atë mënyrë qe derisa në aksident trafiku ishte vete aksidentuar e ishte dërguar ne trajtim mjekësor ,ngritët nga shtrati ku ishte duke marr ushqim , e me shenja dukshëm te konsumit te alkoolit shanë e ofendon e me pas nga dora e heqë ushqimin e me grushte e godet xhamin te cilën e dëmton tërësisht.

-me çka ka kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333par. 1 të KPRK-së.

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73, dhe nenit 333/1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarin D. Zh. e ,

G J Y K O N

D. ZH., i cakton dënimin me gjobë në shumë prej **200,00 € (dyqind) euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së , do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 € (njëzet euro)**.

E dëmtuara –Spitali Rajonal “.... “ ne Gjakovë , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë ne emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.1108/2017 e dt.30.01.2018, ndaj të akuzuarit D. Zh. nga Gjakova, për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1 të KPRK-së .

Komfor neni 493 të KPPK-së , PTH në Gjakovë , kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptoj dënim me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së neni 333/1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me burgim gjerë në 1(një) vit .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor neni 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e neni 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi Penal nr. nga Njësiti i Hetimeve pranë Stacionit Policor në Gjakovë,
- Raporti i policisë 23.07.2017
- Raporti i shpejt dt. 27.07.2017,
- Raporti i emergjencës me nr. 9356 dt.23.07.2017,i Spitalit Rajonal “...”
- Deklarata e dëshmitarit F. A. e dhënë në polici me dt. 23.07.2017,
- Deklarata e të pandehurit D. Zh. me dt.23.07.2017,
- Foto-dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform neni 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.58/18 te dt. 09.03.2018

Sekretarja juridike:
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.